
akt
themelimi

Fra&Sere
Manifatture ”
sh.p.k

K O N T R A T I T E E L M

Data e themelimit :

19.07.2018



REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERËVE
DHOMA E NOTERËVE VLORE
N.REP. 1507 N.KOL. 705/1

Sot, me datë nentembdhjete korrik dymijë e tetembëdhjetë (19.07.2018), para meje noteres Ermira L. Jano, me zyrë noterie në Fier, lagja "29 Nentori", rruga "Dervish Hekali", numër 2, u paraqit personalisht:

Z. ANTONIO CISTERNINO, me atesi Egidio, dtl 19.05.1966, lindur dhe banues ne Narto- Lecce, Rruga "Tolstoi Leone" (EX A-11), Itali, shtetas italian, me ID me numer AS 7321086, madhor dhe me zotësi te plotë për të vepruar, identitetin e të cilit e verifikova sa siper, i cili me deshirë te lirë dhe me vullnet te plotë, deklaroi perpara meje, se ka vendosur te themeloje nje sh.p.k. me emertimin "**Fra & Sere Manifatture**", ne Fier, ne lagjien "Bishanake", Rruga Skenderbeu, Pallati nr 2, kati 2, ap.15, ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe ligjit numer 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit".

KONTRATE THEMELIMI

AKT THEMELIMI

i shoqërisë „Fra & Sere Manifatture” sh.p.k

Neni 1

Antonio Cisternino, me cilesine e ortakut te vetem, vendosi themelimin e shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar te emertuar « **Fra & Sere Manifatture** »

Neni 2

Kjo shoqëri fiton personalitet juridik, sipas te drejtes shqiptare, pas regjistrimit ne QKR dhe aktiviteti i saj bazohet ne kete Akt Themelimi, Statutin qe i bashkalidhet ketij Akti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 3

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: ne Fier, ne Lagjien Bishanake, rruga Skenderbeu, pallati nr 2, kati 2, ap.15, me te drejten per te ndryshuar adresen e saj, si dhe per te hapur dege e filiale te tjera ne te gjithë vendin.

Neni 4



Kapitali fillestar i kesaj shoqerie eshte ne shumen totale prej **10 000** (dhjete mije)leke. Ai perbehet nga kontributi ne para i ortakut te vetem, qe do te derdhet nga ai ne nje banke ne Shqiperi.

Kapitali eshte nenshkruar plotesisht nga ortakut .

Shoqeria disponon lirshmerisht kete shume pas regjistrimit ne regjistrin tregtar te QKR-se .

Neni 5

Kohezgjatja e kesaj shoqerie do jete me afat te pacaktuar, por qe mund te shperbehet ne cdo kohe sipas rasteve te parashikuara ne Statut (shperberja dhe likuidimi) .

Neni 6

Objekti tregtar: **prodhim konfeksionesh, punime artizanale, qendisje me dore.**

Shoqeria kryen çdo lloj aktiviteti ne raport me objektin apo te afte per ta favorizuar ate.

Shoqeria zbaton te gjithe ligjet dhe aktet nenligjore te duhuara. Ajo zbaton standartet me te mira te etikes profesionale

Shoqeria per te realizuar objektin e saj mund te perdore me hua ose me shperblim, toke , te marre me qira, te blej dhe te administroj ambjente, magazina, automjete, pajisje, linja prodhimi per kete lloj aktiviteti, makineri, etj

Sidoqofte shoqeria nuk do kufizohet vetem ne keto aktivitete, ajo do kete te drejte te kryej cdo aktivitet tjeter te ligjshem.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ka ortakut themelues, jashte saj.

Neni 7

Fillimi i veprimtarise tregtare te shoqerise do te lidhet me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit te Bizneseve ne Shqiperi.

Neni 8

Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kesaj shoqerie mbrohen nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 9

Administrimi i shoqerise do te behet nga administratori i saj qe eshte edhe ortakut i vetem:

Antonio CISTERNINI, me atesi Egidio, dtl 19.05.1966, lindur dhe banues ne Nardo, Rruga "Tostoi Leone" Lecce, Itali, me ID me numer AS 7321086, shtetas italian.

Ne veprimtarine e tij , ai ushtron te drejtat dhe pergjegjesite, sic percaktohen ne kete Akt Themelimi, ne Statut dhe Legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Ai ka te drejten e perfaqesimit te shoqerise dhe te administrimit te brendshem te saj.

Neni 10

Shoqeria per te realizuar objektin e saj do punesoje punetore vendas edhe te huaj. Ne marredheniet e tyre te punes shoqeria do te respektoj legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 11

Ne rast vdekje te ortakut ,pjeset e tij ne kapitalin e shoqerise i kalojne trashegimtareve te tij, sipas Kodit Civil te R. Shqiperise , kapitulli " Mbi trashegimine".

Neni 12

Dispozita me te hollesishme per drejtimin e funksionimin e kesaj shoqerije jane parashikuar ne Statutin qe i bashkelidhet ketij akti.

Per cka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete kontrate themelimi vepron ligji " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" numer 9901, date 14.04.2008, i ndryshuar.

Ky akt themelimi u redaktua ne tri origjinale ,me vlere te njëjtë dhe i eshte shpjeguar z. ANTONIO CISTERNINO nga përkthyesi zyrtar i gjuhës italiane z. Rezart Rushanaj , i njohur nga une noteria personalisht . Themeluesi i shoqerise z. ANTONIO CISTERNINO pranoi se ne kete akt eshte pasqyruar vullneti i lirë i tij, se e kuptoi perktimin, e pranoi ate dhe e nenshkroi kete akt para meje noteres si shprehje e vullnetit te tij te lire.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

ANTONIO CISTERNINO




NOTERE

ERMIRA L. JANO

KONTRATE THEMELIMI

Përkthyesi
Rezart Rushanaj





REPUBLIKA E SHQIPERISE
 DHOMA E NOTEREVE VLORE
 N.repertori 1509



pulla u pagua

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, me daten nentembehjete korrik dymije e tetembehjete (19.07.2018) , para meje noteres **Ermira L. Jano** , me zyre noterie ne Fier, lagjia " 29 Nentori", rruga " Dervish Hekali" nr 2, u paraqit personalisht :


- **Z. ANTONIO CISTERNINO**, me atesi Egidio, dtl 19.05.1966, lindur dhe banues ne Narto Lecce, Rruga " Tolstoi Leone"(EX A-11), Itali, shtetas italian, me ID me numer AS 7321086 , madhor me zotesi juridike dhe me zotesi te plote per te vepruar, identitetin e te cilit e verifikova sa me siper, i cili me deshire te lire dhe me vullnet te plote nenshkroi para meje , nen cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "**Fra & Sere Manifatture**" ,(me adrese ne Fier, ne lagjien " Bishanake", Rruga Skenderbeu) , statutin e kesaj shoqerie .

Une noteria vertetoj vullnetin dhe nenshkrimin e tij bazuar ne nenin 55 te ligjit n.7829 date 01.06.1994 "Mbi Noterine" dhe udhezimi 6291 date 17.08.2005 te Ministrise se Drejtesise.

Komunikimi im me shtetasin italian Antonio Cisternino u be i mundur permes perkthyesit zyrtar te njohur prej meje personalisht Rezart Rushanaj bazuar ne nenin.

NOTERE

Ermira L. Jano





Statut

“*Fra&Sere Manifatture*”
sh.p.k

Themeluar date 19.07.2018

statut sh.p.k.

Statuti i shoqërisë

"Fra & Sere Manifatture" sh.p.k

Sot, me datë nentembëdhjete korrik dymijë e tetembëdhjetë (19.07.2018), me dëshirë të lire dhe me vullnet të plote, **une ANTONIO CISTERNINO**, me atesi Egidio, dtl 19.05.1966, lindur dhe banues ne Narto- Lecce, Rruga "Tolstoi Leone"(EX A-11), Itali, shtetas italian, me ID me numer AS 7321086, nenshkrova statutin e shoqërisë "**Fra & Sere Manifatture**", shpk, me adrese ne Fier, ne lagjien "Bishanake", Rruga Skenderbeu, Pallati 2, i hartuar ky statut, ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Në këtë statut, për çfare nuk është parashikuar shprehimisht ketu, vepron Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare":

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 19 korrik 2018, është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emertimin "**Fra & Sere Manifatture**".

Themeluesi i shoqërisë dhe njekohesisht ortaku I vetem, ka te dhenat e meposhtme:

- 1- ANTONIO CISTERNINO**, me atesi Egidio, dtl 19.05.1966, lindur dhe banues ne Narto Lecce, Rruga "Tolstoi Leone"(EX A-11), Itali, lagjia 4, shtetas italian, me ID me numer AS 7321086,

Neni 2:

Objekti

Objekti tregtar: **prodhim konfeksionesh, punime artizanale, qendisje me dore.**

Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti ne raport me objektin apo te afte per ta favorizuar ate.

Shoqëria zbaton te gjithë ligjet dhe aktet nenligjore te duhuara. Ajo zbaton standartet me te mira te etikës profesionale

Shoqëria per te realizuar objektin e saj mund te perdore me hua ose me shperblim, toke, te marre me qira, te blej dhe te administroj ambjente, magazina, automjete, pajisje, linja prodhimi per kete lloj aktiviteti, makineri, etj

Sidoqofte shoqëria nuk do kufizohet vetem ne keto aktivitete, ajo do kete te drejte te kryej cdo aktivitet tjeter te ligjshem.

Shoqëria nuk pergjigjet per detyrimet qe ka ortaku themelues, jashte saj.

Neni 3: Kohëzgjatja

Vepimtaria e shoqërisë do të jetë për një kohë të pakufizuar .

Neni 4: Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: në Fier , në Lagjien Bishanake, rruga Skenderbeu, pallati nr 2, kati 2, Ap.15, me të drejtën për të ndryshuar adresën e saj, si dhe për të hapur dege e filiale të tjera në të gjithë vendin .

Kreu II Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i kësaj shoqërie është në shumën totale prej **10 000** (dhjetë mijë) leke.

Ai përbehet nga kontributi në para i ortakut të vetëm, që do të derdhet nga ai në një bankë në Shqipëri.

Kapitali është nënshkruar plotësisht nga ortakut .

Shoqëria disponon lirshmerisht këto shuma pas regjistrimit në regjistrin tregtar të QKR-se .

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në vlerë monetare dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga ortakut i vetëm, i cili merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

KREU III

Organet vendimmarrese dhe drejtuese

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

kësaj pike;

- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakut në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'i dërgohet ortakut të vetem jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaku i vetem është dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse merr pjesë ortaku i vetem me të drejtë vote.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortaku i vetem është pranishëm personalisht, voton me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së ortakut të vetem asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me votën zoteruese të kapitalit, të ortakut të vetem pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos po në këto mënyra edhe për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
ç) përcaktimin e shpërblimeve
b) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
c) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
dh) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përfshirja nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i parë të shoqërisë :

- **ANTONIO CISTERNINO**, me atesi Egidio, dtl 19.05.1966, lindur dhe banues në Narto Lecce, Rruga "Tolstoi Leone"(EX A-11), Itali, lagjia 4, shtetas italian, me ID me numer AS 7321086 ,

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
b) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë
ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanëjë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Ai ka barren e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë

në mënyrë solidarë.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit . Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17 Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i

veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me kete statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te lind midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 22.

Ky statut u redaktua ne tri origjinale ,me vlere te njëjtë nga ortaku i vetem i shoqërisë z. ANTONIO CISTERNINO ,i cili, e pranoi ate dhe e nenshkroi kete statut me vullnetin e tij te lire.

ORTAKU I VETEM THEMELUES DHE ADMINISTRATORI I VETEM

ANTONIO CISTERNINO



Përkthyesi
Rezart Kushi

